

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje paisje lodra, paisje rekreative dhe element Urban”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Lodra 37520000-9, Lodra me rrota 37522000-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 995 667 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **Lekë pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar:

Për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik, Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sepse ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuara nga organet tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006” Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2023)**, ku operatori ka selinë.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime të mëparshme, të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se **20%** të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - a. kontratën e lidhur si dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve dhe/ose
 - b. faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 gërma ”b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i paisur me Certifikatën **ISO 9001: 2015** për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, të akredituar nga institucione shtetërore vendase ose të huaja, objekti i së cilës të jete në përputhje me objektin e prokurimit (*e vlefshme*).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikatën, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Është një standart ndërkombëtarë i dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, i cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime konform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e APR-së në rritjen gjithnjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i paisur me Certifikatën **ISO 45001: 2018** për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, të akredituar nga institucione shtetërore vendase ose të huaja, objekti i së cilës të jete në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

APR është e angazhuar gjithnjë e më shumë për shëndetin dhe sigurinë në punë, për këtë qëllim vijon të harmonizoj procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara dhe në përputhje me politikat e saj. Ky standart përcakton kërkesat minimale për një praktikë më të mirë të sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke ndihmuar të kontrollojnë rreziqet dhe rrisqet e tyre, ndërsa rrit performancën e tyre.

Ky standard gjithashtu siguron që kompani të ndryshme të jenë në përputhje me kërkesat dhe legjislacionin më të fundit të shëndetit dhe sigurisë.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqes nga prodhuesi certifikatat e mëposhtme:

- **ISO 9006-1:2018** mbi kualitetin e saldimeve, të akredituar nga institucione shtetërore vendase ose të huaja, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).
- **FSC-STD-40-004 V3-0** mbi kualitetin e lëndës drusore, të akredituar nga institucione shtetërore vendase ose të huaja, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).
- **S SH EN: 1176-1: 2017** mbi përdorimin e pajisjeve në ambiente të jashtme dhe të sigurta në përdorimsipas normave EU.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

- ISO 9606-1:2018 për kualitetin e Saldimeve:

Është standart që specifikon kërkesat për testimin e kualifikimit të saldatorëve për saldimit me shkrirje të çelikut. Kur kualifikohen saldatorët, theksi vihet në aftësinë e saldatorit për të manipuluar me dorë elektrodën, pishtarin e saldimit ose tubin e saldimit, duke prodhuar kështu një saldimit me cilësi të lartë.

Ky standart ka rëndësi në këtë objekt pasi veç strukturave të drurit që kanë modulet, një specifikë shumë të rëndësishme zënë dhe elementët metalik që lidhin modulën me tokën me anë të ankerimeve.

- FSC-STD-40-004 V3-0 për kualitetin e lëndës Drusore:

Ky standart siguron menaxhimin dhe prodhimin e lëndës drusore, brenda një organizate që demonstron produkte të etiketuara dhe që vijë nga pyje të menaxhuara mirë (të kontrolluara), materiale të rikuperuara ose perzierja e tyre. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e APR-së si institucion që mbulon administrimin e Pyjeve dhe Kullotave në territorin e Bashkisë Tiranë.

- S SH EN: 1176-1: 2017 për sigurinë e përdorimit të pajisjeve në ambjentet e jashtme dhe të sigurta në përdorim:

Ky kriter specifikon kërkesat e përgjithshme të sigurisë për pajisjet e lodrave publike dhe sipërfaqeve të instaluar në mënyrë të përhershme, për të gjithë fëmijët. Qëllimi i këtij kriteri është të sigurojë një nivel të duhur të sigurisë kur luan në këto pajisje lodrash ose përreth tyre, duke promovuar aktivitete dhe karakteristika të njohura për fëmijët që përfitojnë përvoja të vlefshme që do t'i mundësojnë ata të përballen me situata të ngjashme dhe jashtë sheshit të lojërave.

Gjithashtu ky kriter është për pajisjet e këndit të lojërave të destinuara për përdorim individual dhe kolektiv nga fëmijët, ku specifikon kërkesat që do të mbrojnë fëmijën nga rreziqet që ata mund të mos jenë në gjendje të parashikojnë kur përdorin këto pajisje.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqes Autorizim nga Prodhuesi ose distributor i autorizuar prej tijë, i cili merr persipër të furnizojë ofertuesin me artikujt objekt prokurimi (nëse autorizimi nuk është në gjuhën shqipe, atëher duhet të jetë i përkthyer dhe i noterizuar).

Argumentim: Ky kriter eshte vendosur ne reference te Specifikimeve teknike. Gjithashtu konfirmimi paraprak me Autorizim për rastet kur ofertuesi nuk është prodhues, ofron më shumë siguri për realizimin e furnizimeve dhe brenda afateve të përcaktuar. Rrit besueshmërin e ofertuesit për realizimin e furnizimeve.

2.3.6 Në mënyre që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogjeve të prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi, në të cilën të tregohen dhe specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen dhe të dhënat e subjektit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është vendosur ne reference te ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40 pika 6 germa (b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Paraqitja e katalogjeve të mallrave, ofron më shumë mundësi për njohjen e produkteve që ofrohen dhe mundëson verifikimin e tyre nëse janë në përputhje mallrat e ofruar me ato që janë objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon mjete për transportim të mallrave, nisur nga specifikat të cilat nevojiten për realizimin e kontratës:

NR	LLOJI I MAKINERIVE	PRONËSIA	SASIA
1	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5ton	në pronësi ose me qira	1 copë

a) *Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr. 9*

b) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit(të vlefshme) dhe lejen e transportit, dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik ,siguracionin e mjetit dhe lejen e transportit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të*

qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

- c) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne nenin 77 , të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40 pika 5/ç të VKM nr.285 ,datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor kerkon mjetet dhe pajisjet teknike nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion .

Shënim: Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pare duhet të dorëzojë prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Në të gjitha rastet kur emri ose marka,njihet një vlefshmëria apo baraz vlefshmëria,ose ekuivalent.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.